



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 02/03/23
Datë: 24. 04. 2023, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen Tretë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 24 Prill, 2023, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK),
3. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV), dhe
4. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
5. Safete Shehu - përfaqësuese (OJQ Qershiza).

Poashtu i pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe zyrtari nga Qendra për Punë Sociale në Junik, z. Behar Fetaj.

Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Komitetit për Komunitete e kryesoj znj. Zejnepe Gaxherri e cila përshëndeti të pranishmit, si dhe prezantoj dhe kërkoj miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informatë mbi numrin e rasteve sociale pranë Kuvendit të Komunës në Junik,
3. Informatë rreth aktiviteteve mujore për çështje dhe kërkesa të komunitetit në lagje dhe fshatra, dhe
4. Të ndryshme.

Rendi i Ditës u shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja znj. Zejnepe Gaxherri kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit, i cili shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika Dytë e Rendit të Ditës
Informatë mbi numrin e rasteve sociale pranë Kuvendit të Komunës në Junik

Lidhur me këtë, zyrtari nga Qendra për Punë Sociale në Junik, z. Behar Fetaj tha, te skema e ndihmës sociale kemi një rënie të lehtë krahasuar me dy tre vitet e kaluara.

Krejtësisht kemi 47 raste të ndihmës sociale me nga një apo më shumë anëtarë. Me nga një anëtar që konsiderohet si familje kemi 9 raste, ndërsa me dy apo më shumë anëtarë të familjes kemi 38 raste, ndërsa asnjë nga këto familje fatmirësisht nuk është në varfëri ekstreme dhe nuk kemi ndonjë të pastrehë.

Mesatarja e të ardhurave të këtyre familjeve është rreth 150.00 E, të cilat për shumicën e këtyre familjeve janë të pamjaftueshme, por falë solidaritetit të qytetarëve të Junikut dhe familjarëve të tyre, mirëqenia e tyre është përmirësuar në këtë periudhë.

Ka donatorë nga Juniku të cilët kësaj kategorie u kanë ndihmuar edhe në forma të tjera; si me ndërrimin e dritareve, me pajisje të kuzhinave, banjave, dhomave të gjumit, dhe meremetime të ndryshme për përmirësimin e standardit të jetesës së këtyre familjeve.

Znj. Safete Shehu pyeti nëse Komuna ndonjëherë ka ndara apo ndanë buxhet për këtë kategori?

Z. Behar Fetaj tha, drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sipas praktikave të deritanishme e ka fondin e veçantë për raste emergjente, ku komisioni shqyrton kërkesat e paraqitura dhe vendos se me çka t'i ndihmohet parashtruesit të kërkesës. Për raste emergjente më të mëdha ato kërkesa i drejtohen Zyrës së Kryetarit, e cila vendos për këto raste specifike.

Znj. Safete Shehu pyeti se si mund të ndihmohen nga skema sociale ndihmësit apo shoqëruesit e personave të palëvizshëm, pra ku të drejtohen për këtë çështje, te Komuna apo te Ministria?

Z. Behar Fetaj tha, me duket se Ministria e Financave e ka komisionin mjekësor që vlerëson kërkesat paraplegjike dhe tetraplegjike. Pra, është një komision i posaçëm, ku në bazë të raportit të mjekut të pacientit vlerësohet statuti i shoqëruesit të pacientit, por kjo nuk është kompetencë e Komunës.

Z. Zenel Maloku ngiti edhe çështjen e regjistrimit të pensionistëve në Komunën e Junikut, dhe pyeti nëse mund të caktohet një zyrtar nga Komuna për kryerje e këtij regjistrimi për ata pensionistë të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë mundësi të shkojnë për regjistrim në QPS-në e Deçanit?

Z. Behar Fetaj tha, Kryetari ka bërë përpjekje të emëroj një zyrtar nga Komuna, por kjo nuk ka ndodhur, sepse kjo është më tepër çështje e Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Pra, komuna nuk ka mundur të gjeneroj një vend të lirë të punës për ta rekrutuar një punëtor të jashtëm, dhe asnjë nga punëtorët e Komunës që i është kërkuar kjo, nuk ka treguar interes për një transferim të tillë, apo për ndërrim të vendit të tyre të punës, për një koeficient më të ultë dhe me kushte jo të favorshme të punës. Prandaj, ky shërbim tani për tani mbetet të kryhet në QPS-në e Deçanit.

Pika Tretë e Rendit të Ditës
Informatë rreth aktiviteteve mujore për çështje dhe kërkesa të komunitetit në lagje dhe fshatra

Në mungesë të zyrtarit nga drejtoria përkatëse për raportim, kjo pikë e Rendit të Ditës nuk u diskutua në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Pika Katërt e Rendit të Ditës
Të ndryshme

Z. Zenel Maloku kërkoj që të bëhet kërkesë që personave të palëvizshëm të iu caktohet një shërbim i regjistrimit nëpër shtëpi, sikurse që është rasti i votimeve në kohë të zgjedhjeve. Ndërsa, çështja tjetër është se vakufi është duke u bërë me pagesë, ndërsa imamët do të paguhen nga vakufi dhe do të bëjnë ç'lajmërimin e vdekjeve të personave apo pensionistëve nga mosha 65 vjeçe e tutje.

Me kaq, kryesuesja znj. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Gëzim Geci

Zejnepe Gaxherri